

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Gani Zabel kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit XH.A. nga fshati ..., komuna e Ranillukut, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.4 të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, XH.A. av. E.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.318/13 të datës 19.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.01.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit XH.A., av. E.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.318/13 të datës 19.10.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, me aktgjykimin, P.nr.318/13 të datës 19.10.2018, të akuzuarin XH.A., e ka shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale kanosja nga neni 185 par.4 të KPRK-së, për të cilën vepër gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, në pajtim me nenin 47 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 500€. Është obliguar të paguaj shumën në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti do të ekzekutohet me dënim me burg. Të akuzuarit XH.A., në dënimin e shqiptuar, do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 14.08.2013 deri më datën 29.08.2013. Të akuzuarit në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69, par 1 në lidhje me nenin 62, par 23, pika 2.7 të KPRK-së, i është shqiptuar dënimi plotësues, marrja e sendit, përkatësisht i është konfiskuar shtëpia, e cila është sekuestruar nga policia dhe e njëjta mbetet për ruajtje në dhomën për korpus delikte të kësaj gjykate. Të dëmtuarit A.M. dhe Y.M., që të dy nga fshati .., komuna e Kamenicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. I akuzuari është detyruar, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit XH.A., av. E.A., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës

penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i njëjti të lirohet nga akuza, ose të prishet dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1257/2018, datë 08.01.2019, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit XH.A., av. E.A., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë, pretendon se janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.8 dhe 1.9 të KPPK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në prova të pa pranueshme, sepse i akuzuari nuk e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë. Me ankesë theksohet se i akuzuari as që i ka kanosur personat në fjalë në ditën, kohën dhe vendin, siç është cekë në aktakuzë, por i akuzuari duke e mbrojtur pronën e tij personale private ka reaguar me fjalë duke i thënë që të mos i vazhdojnë punimet në atë pjesë të pronës e cila është pronë e tij, por ti ndërprejnë punimet nga punëkryesi. Me ankesë pretendohet se shkeljet e lart cekura mjaftojnë që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në ankesë dhe as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, dispozitivi i aktgjykimi është në përputhje të plotë me arsyetimin, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 të KPP-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 7 të KPP-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të pa provuara, ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit duke e arsyetuar se për çfarë arsye nuk e pranon këtë mbrojtje. Po ashtu, kolegji penal i kësaj gjykate duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare vlerëson se pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit, se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në prova të pa pranueshme, e duke mos e cekur asnjë provë të tillë, nuk është i bazuar sepse aktgjykimi i ankimuar bazohet në prova të pranueshme dhe i mbështetur në prova reale dhe të ligjshme, pra provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës dhe në bazë të të cilave është nxjerrë edhe aktgjykimi, janë prova të cilat janë nxjerrë konform dispozitave ligjore dhe atë kapitullit XVI të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtat nuk janë kontestuese dhe kanë bazë të artikuleshme dhe me të drejtë gjykata i ka çmuar si

thelbësisht të mbështetshme dhe në bazë të tyre edhe ka përcaktuar fajësinë e të akuzuarit.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon që gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë është vërtetuar në këtë çështje, në kuptim të nenit 386 par.2 dhe 3 të KPPRK-së, Sipas ankesës, dëshmitarët në mënyrë të ndryshme e përshkruajnë rastin, duke deklaruar se sëpatën e ka mbajtur pas shpine edhe asnjëherë nuk e ka përdorur për kanosje ndërsa sipas diapozitivit të aktgjykimi ankimor i akuzuari është shpallur fajtor se me datën 14.08.2013 në ora 13.00 në fshatin ..., për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me pronën i ka kanosur të dëmtuarit A. dhe Y.M. nga fshati Topanicë, ku në atë moment i akuzuari afrohet në vendin e ngjarjes, ku fillimisht i fyen të dëmtuarit A. dhe Y.M., pastaj me sëpatë i kanosë duke ju thënë “ që të njëjtit ta ndërpresin punën, në të kundërtën do t’ju pres me sopatë” dhe në këtë mënyrë i akuzuari kinse me veprimet e tij tek të dëmtuarit shkakton frikë, ankth dhe rrezik për jetë.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet në ankesën e ushtruar. Se i akuzuari, ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së, në pa mëdyshje është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë se i akuzuari me datë, kohë dhe vend sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë me anë të aktakuzës. Ky fakt është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarëve- të dëmtuarve A. dhe Y.M., dëshmisë së dëshmitarëve R.Z., F.M. e F.B. si dhe nga provat materiale që gjenden në shkresa të lëndës. Kolegji penal i kësaj Gjykate, bazuar në deklaratat e personave të lartcekur, ka vërtetuar se i akuzuari ditën kritike ka pasur sopatë në duar dhe se i njëjti, pasi që fillimisht i fyen tani të dëmtuarit, i njëjti i është kanosur tani të dëmtuarve me fjalët “ që të ndërpresin punën, në të kundërtën do t’i pres me sopatë”. Sopatën në duart e të akuzuarit e ka pa edhe zyrtari policor R.Z., i cili me kolegët e tij ka shkuar në vendin e ngjarjes pas thirrjes telefonike nga tani të dëmtuarit. Deklaratat e të dëmtuarve si dhe dëshmitarëve tjerë përputhen njëra me tjetrën si dhe me provat materiale të propozuara në aktakuzë.

Prandaj, nga e gjithë kjo, si dhe vlerësimet dhe arsyetimet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale dhe drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin e ka shpallë fajtor për kryerjen e veprën penale kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së, prandaj ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit edhe sa i përket shkeljeve të ligjit penal në dëm të të akuzuarit respektivisht pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit se në rastin konkret nuk ka elemente të veprës penale për të cilën është akuzuar i mbrojturi i tij, por se bëhet fjalë për veprën penale vetëgjyqësia, refuzohet si e pabazuar sepse veprimet e të akuzuarit në këtë rast paraqesin elemente të figurës së veprës kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK, për të cilën i akuzuari XH.A. është akuzuar dhe është gjykuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit, me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të mbrojturit të tij është tejet i ashpër dhe se e njëjta gjykatë me

rastin e vendosjes lidhur me shqiptimin e dënimit nuk ka vlerësuar rrethanat lehtësuese. Nuk ka propozuar asnjë masë tjetër por vetëm anulim të aktgjykimit të ankimuar.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 74 të KPRK, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin Gjykata mori gjendjen jo të mirë ekonomike, faktin se është person i shtyrë në moshë si dhe kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, sepse e njëjta është kryer në vend publik, në prani të kalimtarëve të rastit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të lartcekura dhe se në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk theksohet asnjë rrethanë lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë e që do të ndikonte në zbutjen e dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit.

Prandaj, duke pas parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe duke pasur parasysh se i akuzuari, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1254/18, datë 11.01.2019**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Jeton Leci**

**Kryetari i kolegjit**  
**Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**Shqipe Qerimi**

**Afrim Shala**